



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5126/6 Prot.

Tirane, me 10.01 2016

## DEKLARATE MJEDISORE

*per Vleresimin Strategjik Mjedisor*

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leshon kete Deklarate Mjedisore per:

Projekti: Plani i Pergjithshem Vendor per Bashkine Kukes

Kerkuesi: Bashkia Kukes

Kufijte e zones qe mbulon plani: e gjithë sipërfaqja e bashkise Kukes se bashku me njesite e saj administrative.

### Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

### Qendrimi i Ministrise:

Plani i propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapesine dhe duke zbatuar te gjitha masat e nevojshme zbutese, te gjitha grup-projektet jane te pranueshme nga kendveshtrimi mjedisor.

Perfshirja efektive e grupeve perkatese te interesit ka kontribuar ne cilesine e vleresimit, ka sjelle te dhena per analizen dhe raportin e VSM-se dhe do te mbeshtese zbatimin e planit pas miratimit te tij, si dhe do te kontribuojte ne nje pranim me te lehte dhe me te zbutur te projekteve perkates.

### Ndikimet e mundshme ne mjedis te planit

Gjate zbatimit te projekteve/veprimeve, priten te ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet positive priten per ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe per popullatat dhe asetet

materiale. Vleresimi i rezultateve tregon se nuk do te kete impakte mbi faktoret klimatike duke konsideruar qe mjetet e transportit do te vijojne te rinovohen ne te ardhmen edhe me tej, gje qe do te sjelle si pasoje permiresim te cilesise se ajrit dhe cilesise se shendetit human, midis te tjerave. per me tej ne pjesen positive te impakteve mbi popullaten dhe asetet materiale do te vije si rezultat i zbatimit te infrastruktures ne pergjithesi qe do te beje te mundur pakesimin e kohes se udhetimit, sigurine ne levizje, perafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe sherbimet publike ne pergjithesi.

Pergjithesisht, shumica e impakteve negative jane te lidhura me fazen e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures ne hapësire dhe pergatitja e kushteve teknike te pershtatshme), pasi Shqiperia ka vecori te theksuara diverse dhe te shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi qe mund te ndikohen konsiderueshem prej zhvillimeve te infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje te gjere dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, uje, etj.). Impaktet negative shfaqen ne fazen e planifikimit prej aspekteve te perdorimit te tokes, efekteve ne uje, natyre (si biodiversiteti edhe zonat me status te mbrojtur), trashegimine kulturore dhe peisazhin. Keto impakte do te kerkojne krijimin e nje programi bashkekohor mbi masat zbutese dhe nje zbatim te pershtatshem te ketyre masave. Impakte negative mbi shendetin human mund te ndodhin per shkak te rritjes se ndotjes nga zhurmat dhe impaktet ne cilesine e ajrit, vecanerisht ne zonat me densitet te larte banimi ku do te perqendrohen edhe nje seri veprimesh ne territor te ngushte dhe kjo do te ndikojte kryesisht ne fazen e zbatimit te projekteve specifike.

#### Vleresimi i perputhshmerise se objektivave:

Objektivat e PPV-se per Bashkine Kukës kane perpuethshmeri mesatare me objektivat e Planit te Menaxhimit te zones se mbrojtur Korab-Koritnik, qe rezulton te jete 1.59. Disa prej aktiviteteve jane plotesisht ne perputhje me Planin e Menaxhimit te zonave te Mbrojtura.

Bazuar ne vleresimin e ndikimit ne mjedis te PPV-se, perpuethshmeria e aktiviteteve te planit me objektivat mjedisore rezulton ne nje nivel shume te mire. Gjate fazes se zhvillimit te projekteve te detajuar, nevojitet te respektohet zonimi i parkut natyror persa u perket nivelit te nderhyrjes, si dhe te merret parasysh Plani i Menaxhimit te Mjedisit per Parkun Natyror Korab-Koritnik.

#### Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te planit ne te gjitha fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.

- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te planit, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia Kukës, nen mbikqyrjen e Agjencise Kombetare te Planifikimit te Territorit, qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.

- Me qellim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të perdoren programe ekzistuese monitorimi, që perputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.
- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjise me të mire të disponueshme, e cila është efiçente në përdorimin e energjise, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efiçasitet dhe qëndrueshmeri dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.
- Plani duhet të nxite realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane dhe në një shkallë me të gjere duke e shtrire këte masë edhe në aktivitete të tjera industriale që krijojnë shkarkime ujërash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujërave sipërfaqesore dhe nëntokesore. Të projektohet infrastrukture bashkëkohore dhe afatgjate të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të ndërhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AKZM për të marrë masat e domosdoshme për mos cenimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjate fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zonën të Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Plani të marrë masa për promovimin e transportit publik të pasagjereve që të kontribuojnë në pakesimin e shkarkimeve në ajër.
- Të zbatohen masa zbutese për zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndërtimit duhet të parashikojnë edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve në mbrojtje. Promovimi brenda dhe në periferite të zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelberta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të këne objektiva të matshme për cilësinë e ajrit.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuader të planifikimit të menaxhimit, vëmendje e vecante të kushtohet për integrimin e zonave të sigurisë nga përmbajtjet dhe atyre ligatinore, ndërkohe që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve të tokës nga përmbajtjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimesise autoktone që i rezistojnë edhe përmbajtjeve).
- Për fillimit të zbatimit të projekteve të zgjidhet ceshtja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.

- Plani duhet te parashikojë kapacitete me të mëdha për landfillet ekzistuese dhe se përdorimi i landfillëve të reja teknologjike duhet të paraprijë investimet në këto.
- Në teresi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standardet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e çelësive të mjedisit të jenë përcësuese duke aplikuar „best practices“.
- Gjate implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse e propozuara në raportin e VSM-se për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarësisht masave dhe rekomandimeve të kësaj Deklarate Mjedisore, gjatë zbatimit të planit është e detyrueshme të zbatohen kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi;
- › Shfaqja e elementeve të rinj ekologjike të panjohur, në kohën që kjo Deklarate Mjedisore është dhënë, sjell si detyrim rivelesimin e saj.
- › Nëse plani nuk është miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit të deklaratës, atëherë deklarata bëhet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Në rast se ministria, strukturat e saj të varesise, njësite të qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, përfshi edhe publikun, konstatojnë se plani nuk zbatohet në përputhje me vendimin për miratimin e tyre dhe nuk respektojnë kushtet e kërkesat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit, atëherë ministria njofton menjëherë autoritetin përgjegjës për zbatimin e miratimit të planit dhe, sipas rrethanave, i kërkon sqarimet përkatëse apo ndalimin e menjëhershëm të zbatimit deri në sqarimin e situatës.
- › Nëse pasojat në mjedis të shëndet, tejkalojnë standardet mjedisore në fuqi, atëherë ministria i kërkon autoritetit miratues të propozues të marrin masa dhe duhet të konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qëllim që të përmbushen standardet mjedisore.
- › Për mos respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe të legjislacionit mjedisor në fuqi ka sanksione ligjore.



**Lefter KOKA**

**MINISTRI**